



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 822/6 prot.

Elbasan, me 24.03.2023

**VENDIM**

Nr 12 datë 24.03.2023

**PËR  
PAGESËN E ORËVE SUPLEMENTARE TË VITIT AKADEMIK 2022-2023**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 04 , datë 17.03.2023 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023", Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Personelit akademik të punësuar me kohë të plotë t'i paguhen deri në 300 orë suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës në auditor për vitin akademik 2022-2023, pasi të ketë përmbushur kohën minimale vjetore të punës prej 1,536 orë.
2. Fondi për këtë pagesë të përballohet nga fondi i parashikuar për shpenzimet e pagave të punonjësve për vitin 2023.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi: Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Njësitë kryesore, Njësitë bazë.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**  
**ARDIAN DURMISHI**